

Veshja ofron rehati, ngrohtësi dhe siguri si edhe duke bërë njëri tjetrin të duken mirë - kjo është se si marrëdhëniet midis burrit dhe gruas janë të definuara në Islam.

Dashuria dhe mëshira në marrëdhëniet bashkëshortore

Profeti (paqja qofte mbi te) gjithashtu inkurajoi njerëzit për të trajtuar bashkëshortet e tyre në mënyrën më të mirë, **“Më të mirët prej jushë janë ata të cilët janë më të mirët në trajtim ndaj grave të tyre.”**

Aishja (gruaja e Profetit) u pyet një herë se si silllet Pejgamberi në shtëpinë e tij. Ajo tha: “Ai është si një nga ju në shtëpi, por është më

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj. Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”

Kur'an 30:21

i butë dhe më bujar ... Ai është gati për të na ndihmuar edhe me punët e zakonshme të shtëpisë, ai vetë i ka qepur rrobat e tij dhe i ka ndrequr keputet e tij”. Në përgjithësi, ai ndihmon çfarëdo lloj pune që gratë i bëjnë.

Pozitat e larta të nënave dhe bijave

Nëna ka ndikim të madh te fëmijë, sidomos në moshën e hershme të tij me dhimbshurinë, kujdesjen dhe dashurinë e saj. Padyshim se sukcesi i një shoqërie është nën ndikimin e nënave. Prandaj Islami i nderon dhe e ngritë statusin e tyre.

Allahu thotë në Kur'an:

Profeti (paqja qofte mbi te) ishte pytur një herë, “O i dërguari i All-llahut, cili prej njerëzve është më meritori në trajtimin tim të mirë?” Ai tha, **“Nëna.”** Njeriu e pyeti edhe dy here rradhazi, “Pastaj kush?” dhe u dha përgjigjen e njëjtë “nëna”. Ndërsa, kur e pyeti për herën e katërt, Profeti iu përgjegj, **“Babai.”**

“Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi.”

Kur'an 46:15

Shpërblimi nuk jepet vetëm me sjellje dhe trajtim të mirë ndaj nënave. Ne fakt Islami ka caktuar një shpërblim të veçantë për rritjen e vajzave që nuk është dhënë për rritjen e djemve.

Profeti Muhamed (paqja qofte mbi te) ka thënë, **“Kujtdo që Allahu i ka dhënë dy vajza dhe është sjellë mirë ndaj tyre ato do të jenë një arësye për të, që të hyjë në Xhenet.”**

Përfundim

Para Islamit femrat janë trajtuar si të turpshme, fëmijët femra varroseshin për së gjalli, prostitucioni ishte i përhapur, divorci ishte vetëm në duart e burrit, trashëgimi ishte vetëm për të fortin dhe shtypja ishte e përhapur. Islami erdhi dhe i largoi këto dukuri. Edhe tani në “ vendet e zhvilluara” femrat nuk e gëzojnë respektin, dinjitetin dhe nderin, që e meritojnë, madje as nuk paguhen njësoj për punën e njëjtë të bërë. Islami megjithatë i konsideron gratë si të çmuara dhe të vlefshme, e jo të parespektura dhe të shtypura. Keqtrajtimi i femrave në disa vende të Lindjes së Mesme, apo në disa familje muslimane, është për shkak të faktorëve kulturorë që disa muslimanë i ndjekin gabimisht, e jo për shkak të Islamit. Përkundrazi. Përse femra të shumta anembanë botës me dëshirë hyjnë në Islam nëqoftëse Islami e shtyp femrën?!

Po perfundojmë me fjalet e Zotit tonë dhe tuaj, Krijuesit dhe Sunduesit të të gjithë meshkujve dhe femrave:

“Nuk ka dyshim se për muslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit e All-llahut e shumëpërmendëset e All-llahut, All-llahu ka përgatitur falje (mekatesh) dhe shpërblim të madh.”

Kur'an 33:35

Informacion

tel 045 633 370 web islamifejaevartetete.com @ broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

Të drejtat e gruas në Islam

Të respektuara

Të nderuara

Të dashura

gjërat
themelore

islamifejaevartetete.com

Mendohet se femrat në Islam janë të nënshtruara, të degraduara, të shtypura, por a është kjo e vërtetë? A janë miliona muslimanë thjesht shtypës apo këto janë vetëm keqkuptime të fabrikuara nga disa media të njëanshme?

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparesi ndaj tyre.”

Kur'an 2:228

ka lejuar gjithmonë. Është vetëm një shpifje të thuhet se islami predikon që femrat nuk kanë shpirt” (Jeta dhe mësimet e Muhamedit (a.s.), 1932).

Meshkujt dhe femrat të gjithë janë të krijuar nga një person i vetëm – nga Profeti Adem (paqja qoftë mbi të). Islami nuk pranon padrejtësi si ndaj femrës apo meshkullit por vetëm drejtësi dhe sjellje të mirë.

Shpërblime dhe përgjegjësi të barabarta

Meshkujt dhe femrat adhurojnë Allahun në të njëjtën mënyrë, do të thotë që ata adhurojnë të njëjtin Zot (All-llahu), kryejnë akte të njëjta të adhurimit, ndjekin të njëjtin libër dhe mbajnë të njëjtin besim. All-llahu (fjala arabe për një Zot dhe krijuesin e vërtetë të të gjithë njerëzimit), gjykon të gjithë njerëzimin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. All-llahu në shumë ajete Kuranore thekson trajtim dhe shpërblim të njëjtë për meshkujt dhe femrat.

“Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, në to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit.”

Kur'an 9:72

në gjykimin apo shpërblimin e njeriut.

Mbi 1400 vjet më parë, Islami u dha femrave të drejta, çfarë femrat në Perëndim vetëm kohëve të fundit kanë filluar t'i gëzojnë (këto të drejta). Në vitin 1930 Annie Besant vërtetoi se” vetem ne 20 vitet e fundit të krishterët anglez kanë filluar ta njohin te drejten e gruas në pronë, ndërsa islami këtë e

ka lejuar gjithmonë. Është vetëm një shpifje të thuhet se islami predikon që femrat nuk kanë shpirt” (Jeta dhe mësimet e Muhamedit (a.s.), 1932).

“Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jushë, meshkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri.”

Kur'an 3:195

Këto ajete tregojnë se shpërblimi është i varur nga veprimet e njeriut e jo nga gjinia e caktuar. Gjinia nuk luan ndonjë rol

Nëse krahasojmë Islamin me fetë e tjera, shohim se Islami ofron drejtësi mes gjinive. Për shembull Islami e hedh poshtë idenë se Hava ishte më shumë fajtorë se Ademi për ngrënjën e pemës së ndaluar. Sipas Islamit të dy ishin fajtorë, ata të dy u penduan dhe Zoti i fali që të dy.

Të drejta të barabarta në kërkimin e diturisë

Të dy palët, meshkujt dhe femrat, janë të inkurajuar në mënyrë të barabartë për të kërkuar dituri. Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë se **“Arsimimi është i detyrueshëm për çdo musliman.”**

Gjithashtu kanë ekzistuar femra dijetare të zonja edhe në kohë të Pejgamberit (a.s.). Disa ishin nga familja e tij dhe të tjerat ishin shoqet e tij ose vajzat e tyre. E shquar në mesin e tyre ishte Aishja, gruaja e Profetit (a.s) përmes së cilës u transmetua një e katërta e ligjit islamik.

Femra të tjera ishin studiuese të mëdha të jurisprudencës dhe kishte studiues të famshëm meshkuj që ishin studentë të tyre.

Të drejta të barabarta në zgjedhjen e bashkëshortit

Islami i ka nderuar femrat duke u dhënë të drejtën për ta zgjedhur një bashkëshort dhe ta mbajnë mbiemrin e tyre familjar edhe duke qenë të martuara. Përveç kësaj shumë kanë përshtypjen se prindërit i shtyejnë me forcë vajzat e tyre të martohen. Kjo është praktikë kulturore (traditë) dhe nuk ka bazë në islam. Në, fakt me Islam është e ndaluar.

Ne kohen e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), një grua erdhi tek ai dhe i tha “Babai im më ka martuar mua me kushëririn tim për ta ngritur gjendjen e tij sociale dhe unë isha e detyruar që ta pranoja.” Profeti shkoi te babai i vajzës dhe në praninë e tij **i dha vajzës opsionet që ta vazhdojë martesën ose ta anulojë martesën.** Ajo u përgjegj, **“O i derguari i Allahut, unë kam pranuar atë që bëri babai im, por unë desha t'ju tregoj femrave të tjera (që ato nuk mund të detyrohen për martesë).”**

Të barabartë por të ndryshëm

Ndërkohë që burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta, si parim i përgjithshëm, të drejtat dhe përgjegjësitë specifike që u jepen nuk janë identike. Burrat dhe gratë kanë të drejta dhe përgjegjësi që e plotësojnë njëra-tjetrën.

Përveç dallimeve anatomike të jashtme dhe të brendshme, shkencëtarët e dinë se ka disa dallime delikate se si truri i meshkullit dhe i femrës përpunojnë gjuhën, informatat dhe emocionet. Vetëm të përmenden disa.

Nje ekspert i socio-biologjisë, Edward O.Wilson nga Universiteti i Harvardit tha se femrat priren të jenë më të avancuara se meshkujt në aftësitë verbale, në ndjeshmëri dhe aftësi sociale, ndërkohë që meshkujt kanë prirje më të lartë në pavarësi, zotërim, aftësi hapsinore dhe matematikore, agresion dhe karakteristika të tjera.

Do te ishte qesharake nëqoftëse do t'i trajtonim të dy gjinitë në mënyrë të njëjtë dhe të injorohen dallimet mes tyre. Islami na mëson se femrat dhe meshkujt kanë ndryshime komplementare në role ku u përshtaten më së miri natyrës së tyre. Zoti thotë:

“E meshkulli nuk është si femra.”

Kur'an 3:36

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dibet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.”

Kur'an 67:14

Bashkësia familjare

Zoti krijoi burrin dhe gruan të jenë të ndryshëm, me role unike, aftësi dhe përgjegjësi. Këto dallime nuk janë parë si dëshmi e superioritetit apo inferioritetit, por të specializimit. Në Islam familja është e një rëndësie qenësore. Burri është përgjegjës për mirëqenien financiare të familjes ndërsa gruaja kontribuon në familje në menyrë fizike, edukative dhe emocionale. Kjo inkurajon bashkëpunim dhe jo konkurrencë. Duke përmbushur përgjegjësitë e tyre të përbashkëta, janë krijuar familje të forta dhe kështu janë formuar shoqëri të forta.

Gjithashtu, emocionalisht as burri e as gruaja nuk jetojnë një jetë të lumtur pa njëri-tjetrin. Allahu bukur e përshkruan këtë duke thënë:

“Ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato.”

Kur'an 2:187